



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6.3.2023

Nr: 96

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARIT TË KZAZ NR. 29, ANËTARIT TË KZAZ NR. 41, BASHKIA
TIRANË, DHE ANËTARIT TË KZAZ NR. 79, BASHKIA FIER**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç” dhe 2, nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, janë kërkuar zëvendësime të anëtarëve të KZAZ-ve nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me shkresat si më poshtë referuar:

- Me shkresën nr. 1128 prot., datë 27.2.2023, ka kërkuar lirimin nga detyra të anëtarit të KZAZ nr. 41, zj. Meli Bashkim Kondi dhe zëvendësimin e tij me zj. Isida Osman Dullaj.
- Me shkresën nr. 1185 prot., datë 28.2.2023, ka kërkuar lirimin nga detyra të anëtarit të KZAZ nr. 79, z. Arben Fejzo Gumeni dhe zëvendësimin e tij me z. Eugert Hiqmet Goxharaj.
- Me shkresën nr. 1307 prot., datë 3.3.2023, ka kërkuar lirimin nga detyra të anëtarit të KZAZ nr. 29, z. Andi Shaban Ajdini dhe zëvendësimin e tij me z. Ardian Lutfi Yzeiraj.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç” dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Lirimin nga detyra të anëtarit të KZAZ-së nr. 29, z. Andi Shaban Ajdini, të anëtarit të KZAZ-së nr. 41, z. Meli Bashkim Kondi, Bashkia Tiranë dhe të anëtarit të KZAZ-së nr. 79, z. Arben Fejzo Gumeni, Bashkia Tepelenë.
2. Emërimin e anëtarit të KZAZ-së nr. 29, z. Ardian Lutfi Yzeiraj, anëtarit të KZAZ-së nr. 41, z. Isida Osman Dullaj, Bashkia Tiranë dhe anëtarit të KZAZ-së nr. 79, z. Eugert Hiqmet Goxharaj, Bashkia Tepelenë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI